REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 73 Prot. Maliq më 08.01.2026

VENDIM

Nr. 7, datë 08.01.2026

Mbi përdorimin e fondit për projektin ***"Shërbime mbështëtëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar"*** me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq, viti i katërt.

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma"b", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqiperisë"*, dhe ligjit nr. 121/2016 *"Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"*, dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 *"Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"*, si dhe shkresës nr. 5055/27 prot, datë 29.12.2025 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për çeljen e fondit prej lekë për vitin 2026. Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1. Të miratojë përdorimin e fondit të deleguar nga Fondi Social i MSHMS me vlerë totale lekë (për vitin 2026) për zbatimin e projektit ***"Shërbime mbështëtëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar"***, të detajuar si më poshtë ;
   1.1 Miratim fondi me vlerë 1152232 lekë për paga dhe sigurime të punonjësve si dhe shpenzimet operative që do të ofrojnë këtë shërbim sipas buxhetit të projektit;

Nr	Aktiviteti	Emertimi pozicionit	Llogaria 600	Llogaria 601	Llogaria 602	Shuma
1	1 punonjes	Koordinator shërbimi(paga 58000 leke /muaj)	696000	116232		812232
2	Shpenzime operative /	Banke ushqimore			190000	190000
		Kosto administrative (karburant Gaz oil)			100000	100000
3	Mbeshtetje direkete ne familje	Ndihme financiare per shpenzime mjekesore			50000	50000
Totali			696000	116232	340000	1152232

2. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015"*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar.

Miratuar me 19 vota
Vota Pro 19
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 08.01.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI